



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 475/ Prot.

Gjirokastrë, më 22/04/2021

V E N D I M

Nr. 12, datë 22.04.2021

MIRATIMI I FORMËS SË DIPLOMËS PËR PROGRAMIN E CIKLIT TË DYTË
"MASTER PROFESIONAL" NË SHKENCA INFERMIERORE

Në mbështetje të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 91, pika 3, udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020 për "Dokumentacioni dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", Kreu IV, vendimit të Senatit Akademik, nr. 10, datë 05.02.2020 "Miratimi i hapjes së programeve të reja të studimit", udhëzimit nr. 10, datë 30.03.2020 "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga IAL dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor", i ndryshuar, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", në mbledhjen e tij të datës, 22.04.2021;

V E N D O S I:

1. Të shfuqizojë vendimin e Senatit Akademik 14, datë 06.04.2020 "Miratimi i formës së diplomës për programin e studimit të ciklit të dytë "Master Profesional" në shkencat infermierore, për arsye të ndryshimit të formatit të diplomës të cilësuar në udhëzimin e ndryshuar nr. 10 datë 30.03.2020.
2. Të miratojë formatin e ri të diplomës në programin e ciklit të dytë "Master Profesional" në Shkencat Infermierore, program që realizohet me 60 kredite (ECTS) në 1 (një) vit akademik.
3. Formatin e diplomës i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Bordit të Administrimit për shqyrtim dhe miratim.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. dr. Bektash MEMA

